


22/06/2023

Hierodëshmor Eusebi i Samosatës. Dëshmorët Zinoni, Zinai. Dëshmor Albani në Britani.



E enjte, 22 qershor 2023- Shenjtori i ditës.

JEMI NË KRESHMËN E APOSTUJVE

Hierodëshmor Eusebi i Samosatës. Dëshmorët Zinoni, Zinai. Dëshmor Albani në Britani.



- DËSHMOR ALBANI NË BRITANI -

Shën Albani vinte nga një familje paganësh të shtresës së thjeshtë. Jetonte në Verulianum, diku midis shek. III dhe IV. Ai takoi një prift të krishterë që ndiqej nga persekutorët, Amfibalin dhe e strehoi në shtëpinë e tij. Albani shikonte mikun të këmbëngulte në lutje natë e ditë me shumë besim e përulësi dhe u prek nga hiri; filloi të ndiqte shembullin e tij dhe ta pyeste në lidhje me krishterimin. Mësimet e atit të shenjtë larguan çdo dyshim idhujtarie dhe më pas mori ndriçimin e Pagëzimit të shenjtë.

Guvernatori romak e mori vesh se misionari fshihej tek Albani dhe dërgoi ushtarë për ta kapur. Kur ata mbërritën në shtëpi, gjetën Albanin që ishte veshur me rrobat e priftit, për të shpëtuar mikun. U mor në gjyq pa kundërshtuar dhe arriti në çastin kur po u flijonin idhujve. Gjykatësi, pasi e mori vesh, e kërcënoi me vdekje nëse do të refuzonte të dorëzonte priftin që kishte fshehur dhe nëse nuk do t'u falej idhujve. Kur i kërkoi të thoshte se çfarë ishte, Albani iu përgjigj se ishte i krishterë, si në

emër ashtu edhe në jetë dhe u tall me idhujt. Atëherë gjykatësi dha urdhër ta rrihnin pa mëshirë, por kur shenjtori i duroi të gjitha si një qenie e patrup e që rrezatonte gëzim, urdhëroi të ekzekutohej pa vonesë.

Tregohet se duke shkuar për tek vendi i dënimit, shën Albani me anë të lutjes bëri që turmën e njerëzve, që kishin ardhur të shihnin ekzekutimin e tij, të kalonte në lumin Ver pa iu lagur këmba. Pas kësaj mrekullie, një nga xhelatët u kthye dhe deklaroi se ishte gati të ekzekutohej ai vetë në vend të shenjtorit. Ndërsa e tërhiqnin zvarrë për ta çuar në majën e një kodre, me lutjet e tij bëri të dilte ujë nga një burim, ku njerëzit mund të pinin. U lut për persekutorët e tij dhe më pas e la veten nën shpatën e tyre.

Në çastin kur koka e tij rrokullisej në tokë, sytë e xhelatit ranë përdhe. Pas një numri të tillë mrekullish, qeveritari vendosi të ndalohej persekutimi dhe të nderohen martirët e Krishtit. Që atëherë, shumë të sëmurë gjetën shërim pranë varrit të shenjtorit dhe kujtimi i tij u përhap në mbarë Anglinë dhe nderohet atje si martiri i parë dhe më pas në gjithë Evropën.



- HIERODËSHMOR EUSEBI I SAMOSATËS -

Shkëlqeu me virtytin e tij të gjithanshëm dhe me besimin e tij korrekt në kohën e perandorit arian Konstand (337-361). Para vitit 360, u hirotonis episkopi i vendlindjes së tij, Samosatës të Mesopotamisë. Luajti një rol aktiv në hirotonisjen e shën Meletit të Antiokisë (12 shkurt) meqë atij iu dorëzua për ruajtje “vendimi”, d.m.th. marrëveshja e arianëve dhe orthodhoksëve për zgjedhjen e Meletit.

Më vonë, me sa duket kur Meleti u shfaq orthodhoks, Konstandi e kërcënoi Eusebin se do t’i priste dorën nëse nuk do t’ia jepte “vendimin”. Kryepriifti, duke kundërshtuar, shtriu pa frikë jo një dorë, por të dyja, saqë shantazhi mbretëror dështoi absolutisht. Si luftëtar i radhëve të para të Orthodhoksisë, mbrojti dogmën e Nikeas në sinodin e Antiokisë të vitit 463. Lidhi miqësi dhe kishte korrespondencë me Vasilin e Madh (1 janar), të cilin e mbështeti në mënyrë vendimtare gjatë zgjedhjes së tij kryepiskop, që të mos binte Kapadokia në duart e herezisë. Madje udhëtoi posaçërisht dhe me nxitim në Qesari, kryeqytetin e saj, pas një nxitjeje me

shkrim të shën Grigorit të Nazianzit (1 janar).

Kishte letërkëmbime edhe me Grigor Theologun (25 janar), i cili në një letër që i dërgoi atij e quan “shtyllë dhe mbështetje të së vërtetës; ndriçues në botë dhe kanun bese”. Meqë e kundërshtonte fuqishëm perandorin filoarian Vali (364-378), u përndoq nga ai dhe në fund u internua në Danub (374). Por pas vdekjes së tij, u rikthye në dioqezën e tij.

U vra më 379 ose 380 me një tjegull që i hodhi nga lart një grua ariane, të cilën hierarku, martir tashmë, arriti ta falte para se të jepte shpirt. Një poet që krijonte, shkruan në shërbesën e tij se bashkë me tjegullën në kokën e shenjtit kishte zbritur dhe kurora qiellore.

Euseb, greqisht do të thotë: besëmirë.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)